

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Digjet banesa, flakët marrin jetën e nënës dhe tre fëmijëve! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/digjet-banesa-flaket-marrin-jeten-e-nenes-dhe-tre-femijeve/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 08:48:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 08:44:35 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	955e9c27b4348daa49d57c1837ee084f56674e401848d707043bd3d2a70237b6
TEKSTI	455ba7ed50e27291a23a1458a31e2b3639f29653d0634e65f89bf4a7146b70e9
PAMJA	69a73d9ff5384d4e22102c607ff30131af168dbfc74fa491f88f9bcd9f11825d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	dfd9ba15ce8af8467495c4bfd7f6615534e6a2eecf15a43b020ba7390ef2ef72
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/dfd9ba15ce8af8467495c4bfd7f6615534e6a2eecf15a43b020ba7390ef2ef72>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Bota

Digjet banesa, flakët marrin jetën e nënës dhe tre fëmijëve!



Marisa Karabeci

29 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO



Një ngjarje tragjike ka tronditur komunitetin në Bootle, Merseyside, në Angli, ku një nënë 36-vjeçare dhe tre fëmijët e saj kanë humbur jetën pasi banesa e tyre u përfshi nga flakët gjatë orëve të para të mëngjesit. Viktimat janë identifikuar si Elisha Brabin, 36 vjeçe dhe fëmijët e saj Leo, 16 vjeç, Ellis, 8 vjeç dhe Prudence, 7 vjeçe. Të katër u gjetën pa shenja jete nga zjarrfikësit në një dhomë gjumi në katin e sipërm të banesës në Stone Square.

Shërbimet e emergjencës u alarmuan rreth orës 03:45 të së martës, më 22 shtator. Një person i pestë u dërgua në spital, pasi kishte pësuar djegie. Hetimet parapake të Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit të Merseyside kanë përcaktuar se zjarri dyshohet se nisi pas një incidenti elektrik, që shkaktoi atë që njihet si “thermal runaway” në një bateri litium-jon. Ky proces mund të shkaktojë një rritje të pakontrolluar të temperaturës dhe përhapje shumë të shpejtë të zjarrit.

Autoritetet nuk kanë bërë të ditur se në cilën pajisje ndodhej bateria. Megjithatë, bateritë litium-jon përdoren gjerësisht në pajisje të ndryshme elektronike, përfshirë biçikletat dhe skuterët elektrikë. Drejtuesi i parandalimit pranë shërbimit zjarrfikës, Kev Johnson, tha se shpejtësia dhe intensiteti i flakëve e bënë jashtëzakonisht të vështirë ndërhyrjen, pavarësisht përpjekjeve të ekipeve të emergjencës.

Autoritetet kanë përsëritur thirrjen për qytetarët që të përdorin vetëm bateri dhe karikues të rekomanduar nga prodhuesit. Ata këshillojnë gjithashtu që një bateri të mos përdoret më nëse fryhet, lëshon erë të pazakontë, nxjerr tym, bën zhurma të çuditshme ose nuk karikohet normalisht.

Sipas të dhënave të shërbimit zjarrfikës, në Merseyside janë regjistruar 150 zjarre të lidhura me bateritë litium-jon që nga prilli 2023 deri në gusht 2026. Në këto incidente kanë humbur jetën pesë persona. Familjarët e Elishës e kanë kujtuar atë si një nënë të përkushtuar, duke thënë se fëmijët ishin qendra e jetës së saj. Për tre fëmijët, familja shprehet se ishin jashtëzakonisht të dashur dhe se

numëroja e tyre ka rënë një numëroje të pakompensueshme.

Ndërkohë, komuniteti lokal është mobilizuar për të ndihmuar familjen. Një fushatë për mbledhjen e fondeve ka grumbulluar më shumë se 12 mijë paund, ndërsa fqinjët kanë treguar se tentuan të ndërhyjnë vetë gjatë momentit të zjarrit, duke kërkuar mënyra për të hyrë në banesë dhe për të shpëtuar familjarët. Në vendin ku ndodhi tragjedia janë vendosur lule, qirinj, lodra dhe fotografi, si homazh për Elishën dhe tre fëmijët e saj.

LAJME TË NGJASHME



Nënë e bijë humbin jetën nga kanceri, vetëm 10 orë larg njëra-tjetrës!

2.5 MIN



Mbyti nënën në gjumë, 53-vjeçari telefonoi ambulancën dhe bënte xhiro në qytet!

1 MIN



Zelensky: Mbi 8 mijë trupa të Koresë së Veriut ndodhen në Rusi!

1.5 MIN



Shuhet papritur në moshën 40-vjeçare mundësi britanik!

1 MIN



Irani ende pret armëpushim dhe heqje sanksionesh për të zhblokuar Hormuzin!

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Pranoi se është homoseksual, habit me deklaratën aktori i njohur: "E kishin më të lehtë të më shihnin si një..."



Vjeshta kalohet më bukur me muzikën e përzgjedhur nga DeeJay-t e TAR!



"Villa Sol Lumière", një oaz paqeje larg kaosit të qytetit!



Nga dhoma e hotelit me Guardiolën të 15 vite si drejtor i Lazios dhe aventura të Milani, Igli Tare në një rrëfim ndryshe!



Ben Affleck pranon se fëmijët qeshin me të kur përpiqet t'u japë këshilla për dashurinë?



Rita Ora tërheq vëmendjen me paraqitjen e fundit, vë në pah linjat trupore!



Vdekja e Giorgos Mazonakis, zbulohet mesazhi i fundit për trajtimin dhe pagesën...



"Para nga qielli"/Parashikimi i Baba Vanga-s për dy shenjat e zodiakut!



Andy Carroll rikthehet në fushën e futbollit pas rrëfimit për sulmin seksual!




"Patëm një dasmë të madhe shqiptare..."/ Dua Lipa ndan pamje nga dasma familjare!

EDITORI SUGJERON



"Dashuria ma ngroh zemrën, shumica e vajzave janë të padashuruara"/Amber Candy: Kur sheh krevatin bosh në mëngjes...



Televizioni hapi i radhës? Amber zbulon ekskluzivisht projektin e ri: Njerëzit duan lumturi, një show që...




"Ku ka më mirë se të kesh një jetë të lirë?"/Amber: Djemtë shqiptarë kanë kompleks...




"Një njeri që ka ndryshuar identitetin..."/Amber Candy: Jam shumë e fortë për t'ia dalë në Shqipëri!



Flirt me ndonjë nga banorët? Amber: Më mirë t'i nxjerr vetë të palarat, se sa të m'i nxjerrin të tjerët...




"Në BBV kupton veten..."/Do të lidhej me një banor brenda shtëpisë? Amber: Unë godas që në fillim!



"Nuk duhet të rihyja, u stepa sepse..."/Amber Candy: Nuk mund të godasësh një banor që është i lodhur...



7 shenja që mund të tregojnë rezistencë ndaj insulinës!



Bëni kujdes! 10 zakone të përditshme që mund të shkaktojnë tritje të sheqerit në gjak...



5 suplemente që mund të mbështesin efektin e ilaçeve për dobësim...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontaktimi
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.